



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 5373 Prot.  
(Lutemi referojuni në rast përgjigjeje)

Tiranë, më 29 . 10 .2021

**URDHËR**

Nr. 85, Datë 29/10/2021

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR MATURËN SHTETËRORE DHE MATURËN  
SHTETËRORE PROFESIONALE 2022**

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.364, datë 24.12.2020, "Për miratimin e Rregullores së Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë",

**URDHËROJ**

1. Miratimin e kalendarit për Maturën Shtetërore 2022, sipas dokumentit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Arsimore Vendore dhe Institucionet Arsimore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**Rezana VRAPI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**



Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë

Tel/fax. +355 4 2419257

Web site: [www.gsha.gov.al](http://www.gsha.gov.al)

e-mail [rezana.vrapi@gsha.gov.al](mailto:rezana.vrapi@gsha.gov.al)

<b>Referenca:</b> Urdhri nr.364, datë 24.12.2020, “Për miratimin e Rregullores së Maturës Shtetërore”.	<b>Periudha/Datat:</b>
<b>Kreu II:</b> <b>Institucionet dhe strukturat përgjegjëse për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore.</b>	
Neni 7, shkronja “o”.	Dërgon në QSHA, brenda datës 19 shkurt 2022, listën e qendrave për provimet e Maturës Shtetërore.
Neni 8, shkronja “m”.	Plotëson brenda datës 30 prill 2022, bazën e të dhënave për maturanët/kandidatët për të gjitha vitet e shkollës së mesme, me përjashtim të vitit të fundit. Secilit maturan/kandidat i jepet një kopje e printuar e rezultateve të hedhura, të firmosura nga maturanti/kandidati, të vulosura dhe të firmosur nga drejtori i shkollës dhe kopja tjetër ruhet në arkivin e shkollës.
Neni 8, shkronja “n”.	Plotëson në periudhën 8 – 19 qershor 2022, bazën e të dhënave për maturanët/kandidatët për vitin e fundit të shkollës së mesme.
Neni 8, shkronja “p”.	Në periudhën 21 – 26 qershor 2022 përfundon procesin e verifikimit dhe konfirmimit të rezultateve në sistem.
<b>Kreu IV:</b> <b>Aplikimi për provimet e maturës:</b>	
Neni 13, pika 2.	Maturanti/kandidati bën aplikimin online, fillimisht në Portalin Qeveritar e-albania në periudhën 16 nëntor – 16 dhjetor 2021, dhe më pas, në portalin “Matura Shtetërore 2021”, në periudhën 17 nëntor – 16 dhjetor 2021. Aplikimi në portalin “Matura Shtetërore 2022”, bëhet edhe sipas afateve të vendosura nga QSHA.
Neni 13, pika 3.	KSHMSH-ja, deri më datë 23 dhjetor 2021 afishon në shkollë, një kopje të bazës së të dhënave, të shkarkuar nga portali i Maturës Shtetërore dhe pret vërejtjet e maturanëve/kandidatëve për korrigjime të mundshme në bazën e të dhënave të regjistruara në portalin “Matura Shtetërore”. Brenda datës 15 janar 2022, KSHMSH-ja bën verifikimet dhe korrigjimet përkatëse në sistem.